

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ÇLIRËSË JE PRAVNOSMAZNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC

NË EMËR TË POPULLIT



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHEM

DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në lëndën penale kundër të akuzuarve [redacted] dhe [redacted] për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1931-4/13 të datës 03.06.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit shtetit Avdullah Abedini, të pandehurve [redacted] dhe [redacted] me datë 27.12.2016 mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuari:

1. [redacted] nga fshati [redacted] i [redacted] Komuna Shtime, i lindur më [redacted], nga i ati [redacted] e ëma [redacted] e gjinisë [redacted], ka të kryer fakultetin e infermierisë, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.përsonal [redacted] - Tel. [redacted]
2. [redacted], nga Shtimja rr. [redacted] i lindur më [redacted], nga i ati [redacted] dhe e ëma [redacted] e gjinisë [redacted] ka të kryer pesë klasë të shkollës fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.përsonal [redacted] - [redacted]
3. [redacted] nga Shtimja rr. [redacted] i lindur më [redacted] nga i ati [redacted] dhe e ëma [redacted] e gjinisë [redacted] ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.përsonal [redacted] - [redacted]

JANË FAJTOR

Sepse me datë me datë 15.09.2013, rreth orës 20.55, në Shtime, në rr.e “ Tiranës”, saktësisht në Kazino “ [redacted], pas një mosmarrëveshje të mëhershme me të dëmtuarin [redacted] dhe të pandehurin [redacted], në atë mënyrë që të pandehurit me ta vërejtur të dëmtuarin që ishte në Kazino, kanë shkuar dhe bashkërisht e kanë sulmuar të dëmtuarin me grushta dhe mjete të forta karrige në pjesë të ndryshme të trupit, fillimishtedhe e kanë sulmuar Brenda në kazino me pas e kishin tërhequr zvarrë deri në rrugë, ku kishin vazhduar ta sulmonin dhe ishin larguar nga aty ku nga pasojat e këtyre goditjeve I dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje e indeve të buta në regjionin e mollzës së djathtë të

fytyrës, enjte të regjionit të hundës, gërvishje në regjionin e shpinës, e të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme për shëndetin,

- me të cilën në bashkëkryerja kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 me par. 2 pika 1.4 lidhur me neni 31 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 4,6,7,23,41,43,46 dhe 73 të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit i

GJYKON

1. Të pandehurin [REDAKTUAR] me DENIM ME GJOBË në lartësi prej 300 (treqind) euro, të cilin denim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
2. Të pandehurin [REDAKTUAR] me DENIM ME GJOBË në lartësi prej 300 (treqind) euro, të cilin denim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe
3. Të pandehurin [REDAKTUAR] me DENIM ME GJOBË në lartësi prej 400 (katërqind) euro, të cilin denim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimet e shqiptuara me gjobë nuk mund të ekzekutohen as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i pandehuri do të vuaj një ditë burgu.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Lipjan, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohen i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në mënyrë solidare të paguajn shumën prej 20 euro dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1931-4/14 e dt. 03.06.2014 i ka ngarkuar të pandehurit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR],

██████████ dhe ██████████ për veprën penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par Ipika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata me aktvendimin P.nr.610/14 të dt.27.12.2016 ka veqar procedurën penale ndaj të pandehurve ██████████, ██████████ dhe ██████████, për arsye se duke u bazuar në njoftimin zyrtar nga Policia e Kosovës – Stacioni në Shtime nr.ref.04/1-05SH-0155/16 të dt.08.04.2016 është njoftuar gjykata se i pandehuri ██████████ nuk gjendet në shtëpi dhe se i njejt gjendet jashtë shtetit në Francë. Në bazë të njoftimit zyrtar nga Policia e Kosovës – Stacioni në Shtime nr.ref.04/1-05SH-0154/16 të dt.08.04.2016 është njoftuar gjykata se i pandehuri ██████████ nuk gjendet në shtëpi dhe se i njejt gjendet jashtë shtetit në Gjermani ndërsa në bazë të njoftimit zyrtar nga Policia e Kosovës – Stacioni në Shtime nr.ref.04/1-05SH-0428/16 të dt.08.11.2016 është njoftuar gjykata se i pandehuri ██████████ nuk gjendet në shtëpi dhe se i njejt gjendet jashtë shtetit në Gjermani.

Duke vepruar sipas kësaj çështje penale ndaj të pandehurve ██████████, ██████████ dhe ██████████ gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor më dt. 27.12.2016 në të cilin Prokurori i Shtetit Avvdullah Abedini, në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri ██████████ ne shqyrtimin gjyqësor, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 246 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, duke kërkuar falje për atë që ka ndodhur, si dhe duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

I pandehuri ██████████ ne shqyrtimin gjyqësor, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 246 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, se rastëshit ka qëlluar aty dhe nuk ka pasur qëllim që ti shkaktoj lëndime të dëmtuarit, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

I pandehuri ██████████ ne shqyrtimin gjyqësor, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 246 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, se i kërkon falje të dëmtuarit, se me të dëmtuarin tani kanë raporte të mira dhe prej asaj kohe nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje duke premtuar se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Me që të pandehurit ██████████, ██████████ dhe ██████████ kanë pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga të pandehurit,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor i datës 27.04.2014, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dhënë në stacionin policor në Shtime me autorizim të prokurorit me datë 15.09.2013, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dhënë në stacionin policor në Shtime me autorizim të prokurorit me datë 16.09.2013, deklarata e dëshmitarit [REDAKTUAR] e dhënë në stacionin policor në Shtime me autorizim të prokurorit me datë 17.09.2013, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dhënë në stacionin policor në Shtime me autorizim të prokurorit me datë 16.09.2013, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dhënë në stacionin policor në Shtime me autorizim të prokurorit me datë 16.09.2013, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dhënë në stacionin policor në Shtime me autorizim të prokurorit me datë 15.09.2013, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dhënë në stacionin policor në Shtime me autorizim të prokurorit me datë 15.09.2013, deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e dhënë në stacionin policor në Shtime me autorizim të prokurorit me datë 16.09.2013, raportin nga QKMF Shtime i datës 16.09.2013 si dhe fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij, pendimin e tij të shprehur për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet e tija, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj mbi bazën e rrethanave të tilla gjykata konform nenit 75 dhe 76 të KPRK-së për të pandehurit bëri zbutjen e dënimit dhe i vërtetoi dënimin me gjobë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurve.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Lipjan, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 450 par.2 nën par.2.6 dhe par.3 dhe neni 451 të KPPRK-së, të pandehurit obligohen që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizën mjeko ligjore në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 20 euro si dhe në emër të paushallit gjyqësor scili veç e veç të paguajnë shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni
penal, P.nr.610/14, dt.27.12.2016**

Sekretarja Juridike ,
Drita Ujupi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është elejuar ankesa në Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopies me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.